



A.nr.266/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.266/2026, të datës 10.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.R, të cilin më autorizim e përfaqëson Avokat Misad Popova nga Podujeva, kundër organit të punësimit/Agjencia Pyjore e Kosovës, në çështjen juridike “*transferim/ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 31.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.266/2026, e datës 10.03.2026, e parashtruar nga ankuesi A.R.
- II. Anulohet** Vendimi Nr.R. APK 1/2026, i datës 27.02.2026, i U.d. Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si dhe si dhe pjesa/pika IV më numër rendor 41 e Raportit të Ristrukturimit me numër protokoli 94, të datës 02.02.2026, të Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet** Komisioni i Ristrukturimit të Agjencisë Pyjore të Kosovës, i themeluar sipas Vendimit me numër protokoli 2109, të datës 05.11.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, të rishqyrtoj çështjen e ankuesit, në atë mënyrë që sistemimi i ankuesit si rezultat i ristrukturimit të jetë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi A.R (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 10.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.R. APK 1/2026, të datës 27.02.2026, të u.d. Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrit të Digjitalizimit dhe Administratës Publike, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për

Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (ZKM) Nr.02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, ka përcjell përgjigje në pretendimet ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa përmbush kriteret e pranueshmërisë sipas nenit 129 të LPPA-së, ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 1226/2026 të datës 10.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 09.03.2026; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 13.02.2025; 13.02.2026; Diplomën me Nr. 082/21 të datës 29.09.201 të ankuesit; Vërtetimin me Nr. 13-270 të datës 10.01.2025; Certifikatën e datës 15.12.2021; Akt Emërimit të datës 07.03.2023; Vendimin Nr.R. APK 1/2026, të datës 27.02.2026, të u.d Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministritë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike Vërtetimin me Nr. 13-08 të datës 13.01.2026; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 19.03.2026; Vendimin e datës 05.11.2025 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në APK; Raportin e punës së Komisionit të Ristrukturimit i datës 02.02.2026; Emaili e datës 31.10.2025 nga L.Z për D.G; Emailin e datës 31.10.2025 nga D.G për L.Z; Formularin e përshkrimit të punës për pozitën Asistent i Pylltarisë datë 31.10.2025; Listën e pagave për ankuesin dhjetor 2025, janar dhe shkurt 2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe së çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, *sepse*:

I. Gjendja e Çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit AE.Nr.13-101/03-0017820.23, të datës 07.03.2023, mbante pozitën Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorimit.
- Më Vendimin Nr.227/ 2025, të datës 05.03.2025, Kryeministri i Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës.
- Drejtori i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me numër protokolli 2109, të datës 05.11.2025, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Agjencinë Pyjore të Kosovës.
- Komisioni i Ristrukturimit për Agjencinë Pyjore të Kosovës, më datë 02.02.2026, ka miratuar Raportin përfundimtar me numër protokolli 94 lidhur me procesin e ristrukturimit në Agjencinë Pyjore të Kosovës,

rrjedhimisht, ankuesi nga pozita e mëparshme *Teknik i Pylltarisë* është propozuar të transferohet në pozitën *Asistent i Pylltarisë*.

-U.d Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin Nr.R. APK 1/2026, të datës 27.02.2026, ka transferuar ankuesin nga pozita *Teknik i Pylltarisë* në pozitën *Asistent i Pylltarisë*.

II. *Pretendimet ankimore*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr.R. APK 1/2026, të datës 27.02.2026, duke pretenduar se vendimi për transferimin e ankuesit është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore ngase është dashur të transferohet në një pozitë të Zyrtarit të Lartë, meqë plotëson të gjitha kushtet ligjore. Vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk gjen mbështetje ligjore e as faktike për shkak që nuk është marr për bazë përvoja e punës për sistemim në një pozitë të zyrtarit të lartë. Kërkon që të ndryshohet vendimi i kundërshtuar dhe të sistemohet në pozitën Zyrtar i Lartë i Pylltarisë.

III. *Pretendimet e institucionit në përgjigjen në ankesë*

Agjencia Pyjore e Kosovës përmes përgjigjes në ankesën të datës 19.03.2026, kundërshton pretendimet ankimore të ankuesit, duke theksuar se procesi i ristrukturimit në këtë institucion është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil. Tutje, thekson se nga analiza krahasueses e bërë nga komisioni, rezulton se ankuesi nuk ka poseduar përvojë të mjaftueshme profesionale relevante në raport me zyrtarët e tjerë të cilët janë propozuar për pozita të nivelit më të lartë, për më tepër në raport me kriteret e përcaktuara ligjore dhe administrative, ai nuk i ka plotësuar kushtet e nevojshme për t' u propozuar në një pozitë të tillë. Sipas kriterit të përvojës së punës dy zyrtarë të tjerë kanë përvojë pune 10 vite e 1 muaj, zyrtar tjetër 8 vite e 10 muaj, ndërsa, tre zyrtarë tjerë kanë pasur akt emërim me profesional 1. Rrjedhimisht, bazuar në vlerësimin objektiv dhe krahasues të të gjithë kandidatëve, z. Ramadani është propozuar dhe më pas sistemuar në pozitën Analist i Pylltarisë, pozitë kjo e përafërt dhe në përputhje me pozitën e tij të mëparshme Teknik i Pylltarisë.

IV. *Vlerësimi i Kolegjit*

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: 1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e

sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të tjera, përmbenë shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...

Po ashtu Kolegji ju referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë respektivisht nenit 13 paragrafi 7, ku përcaktohet: “7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriterë: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit”.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër dhe duke u bazuar në Rregulloren (ZKM) Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, njësie organizative e Drejtoratit Koordinues Regjional-Prishtinë, në të cilën ka qenë i punësuar ankuesi, është paraparë në nivel Departamenti Regjional, me tri divizione: Divizioni për Mbrojtje dhe Ruajtje të Pyjeve; Divizioni për Produktet Drunore, Jo drunore dhe Funksionet tjera të Pyllit dhe Divizioni për Ripërtërije, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime, ndërsa, pozita e ankuesit si teknik i pylltarisë është shuar dhe mbi këtë bazë Komisioni ka vendosur që ankuesi të sistemohet në pozitën Asistent i Pylltarisë në Divizioni për Ripërtërije, Pyllëzime, Kullota dhe Këshillime.

Andaj, meqenëse pozita e ankuesit është shuar, e duke qenë se sipas përgjigjes në ankesë të datës 19.03.2026 institucioni punëdhënës ka pohuar se ankuesi nuk ka poseduar përvojë të punës profesionale dhe relevante në raport me zyrtarë të tjerë që janë caktuar në pozita të tjera me të larta në raport me pozitën që kanë mbajtur, Kolegji i Këshillit një konstatimi të tillë nuk ja fal besimin, sepse, në raste të tilla Komisioni i Ristrukturimit duhet të ve në zbatim procedurën e përcaktuar me nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, rrjedhimisht, duhet të aplikohet sistemi i pikëzimit i cili bazohet në vlerësim të disa faktorëve e jo vetëm të përvojës së punës gjegjësisht përvojës së nëpunësit në shërbimin civil; mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe trajnimet e nëpunësit, dhe se në varësi të pikëve me të larta fitohet e drejta e sistemimit në pozitë përkatëse.

Bazuar në të gjeturave dhe konstatimeve si më sipër, Kolegji i Këshillit vlerëson se procedura e transferimit të ankuesit si pasojë e ristrukturimit nuk është në pajtim me ligjin material, andaj, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në kuptim të nenit 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me detyrimin që ky i fundit në ri-procedurë të marrë parasysh pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij

vendimi ashtu që sistemi i ankuesit të behët duke ndjekur procedurën e pikëzimit sipas nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.266/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat Mirsad Popova;
- Organit të punësimit: Drejtorit Ekzekutiv, Komisionit të Ristrukturimit, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në APK;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.